


BASHKËPUNIMI POLICOR MES KOSOVËS DHE SERBISË



Belgrade Centre for Security Policy



Kosovar Center for Security Studies

Bashkëpunimi policor mes Kosovës dhe Serbisë

Beograd dhe Prishtinë
2015

Botues:

Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë
[QBPS]

Djure Jaksica, 6

11000 Beograd

Tel. and Fax.: +381 11 328 7226; 328 7334

Email: office@bezbednost.org

Web: www.bezbednost.org

dhe

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
[QKSS]

Sylejman Vokshi, Blloku B, Hyrja 2, Nr. 1

10000 Prishtinë

Tel.: +381 38 221 420

Email: info@qkss.org

Web: www.qkss.org

Autor:

Shpend Kursani

[Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë]

Editor:

Florian Qehaja

[Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë]

Dizajni dhe faqosja:

Marko Marinković

Beograd dhe Prishtinë, 2015

E drejta e autorit © 2015 QKSS dhe IDM

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ISBN 978-86-6237-059-4

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në baza të dhënash, apo të transmetohet në ndonjë formë përmes sistemeve elektronike, mekanike, fotokopjimit, incizimit apo në ndonjë mënyrë tjetër pa lejen para-prake të botuesve.

Ky botim u realizua në kuadër të projektit "Forumi Hulumtues për Siguri: Beograd-Prishtinë-Tiranë", i mbështetur nga qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë. Pikëpamjet dhe analizat e paraqitura në këtë botim janë të autorit dhe nuk i përfaqësojnë medoemos pikëpamjet e qeverisë së Norvegjisë, apo të ndonjë organizate tjetër që ka të bëjë me to.



PËRMBAJTJA

HYRJE	6
ARKITEKTURA INSTITUCIONALE	7
MËNYRA E BASHKËPUNIMIT.....	9
SFIDAT.....	11
REKOMANDIMET.....	12

HYRJE

Edhe Kosova edhe Serbia ndodhen në një rajon të ndikueshëm nga aktivitetet e ndryshme të krimit të organizuar. Sipas Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim (UNODC), rajoni i Ballkanit është njëri prej koridoreve kryesore të trafikimit të heroinës që lidh Afganistanin me tregjet e mëdha të Europës Perëndimore. “Rruga e Ballkanit kalon nëpër Republikën Islamike të Iranit (shpesh nëpër Pakistan), Turqi, Greqi dhe Bullgari përmes Europës Juglindore të tregut të Europës Perëndimore, me një vlerë vjetore të tregut prej rreth 20 miliardë dollarë amerikan.”

Përkundër vlerës së madhe të tregut të drogave që kalojnë nëpër Ballkan, vetëm 24 përqind prej 73.7 tonëve të heroinës së kapur kudo në botë është zënë në rajon, ndërsa 39 përqind kapet në Lindjen e Afërt dhe të Mesme dhe Azinë Jug-perëndimore, dhe 10 përqind në Europën Qendrore dhe Perëndimore.

Sipas UNODC, “grupet e organizuara kriminale po bëhen më ndërkombëtare, shumë-etnike, dhe të orientuara në shumë krime, derisa ato diversifikojnë një larmi krimesh që përfshijnë mallëra të ndaluara dhe të pandaluara që tregtohen për fitime”.¹ Ngjashëm, “[n] atyra ndërkombëtare e krimit të organizuar nënkupton se rrjetet kriminale krijojnë lidhje përtej kufijëve e poashtu i tejkalojnë dallimet gjuhësore e kulturore në kryerjen e krimit të tyre. Krimi i organizuar nuk është i pandryshueshëm, por ai përshtatet derisa shfaqen krime të reja dhe derisa marrëdhëniet mes rrjeteve kriminale bëhen edhe më fleksibile edhe më të sofistikuara, me shtrirje gjithnjë e më të madhe nëpër glob.”² Ky është veçanërisht rasti i Kosovës dhe Serbisë. Pavarësisht prej mosmarrëveshjeve politike dhe tensioneve politike dhe etnike mes dhe bren-

Kategoritë e aktiviteteve kriminale sipas UNDOC:

- Trafikimi i drogave
- Armët e zjarrit
- Ilaqet mashtruese
- HIV dhe AIDS
- Trafikimi i njerëzve dhe kontrabandimi i migrantëve
- Shpërlarja e parave
- Krimi i organizuar
- Piratëria
- Parandalimi i terrorizmit
- Krimi ndaj pyjeve dhe kafshëve të egra

da dy shteteve, grupet e organizuara kriminale që funksionojnë në dhe mes Kosovës e Serbisë nuk njohin asnjë pengesë etnike apo gjuhësore dhe janë të prira t’i përshtaten rrethanave të reja të krijuara në terren.

Kosova dhe Serbia³ nuk janë shtetet e vetme përgjegjëse për luftimin e aktiviteteve të organizuara kriminale në rajon; megjithatë, mungesa e marrëdhënieve formale diplomatike mes tyre i bën ato dhe rajonin më të cenueshme nga aktivitetet e ndryshme kriminale. Një situatë në të cilën ka mosmarrëveshje themelore politike mes dy shtetesh nënkupton liri më të madhe operimi për kriminelët dhe iu siguron atyre më shumë mundësi për të bërë vepra të tilla.⁴ Mosmarrëveshjet politike mes Kosovës dhe Serbisë nënkuptojnë boshllëq të mëdha në menaxhimin adekuat dhe kontrollin e kufirit të përbashkët, sidomos në pjesën e ndjeshme veriore të Kosovës. Kjo hap derën për kontrabandim të shumë-përhapur të migrantëve, të cilët pastaj e gjejnë rrugën për në Hungari e pastaj për në Zvicër e në vendje tjera në Eu-

1 Archive, UNODC. Qasur me 08.10.2014. http://archive.org.org/u/unodc.org/2013-12-03_3252578_7/Drug_Prevention_Treatment_and_Care/

2 UNDOC, “Organized Crime”. Qasur me 16.04.2014. Në dispozicion tek: <http://www.unodc.org/unodc/en/organized-crime/index.html>

3 Kosova ka nënshkruar dhe ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare mbi bashkëpunimin policor me të gjithë fqinjët e saj përveç me Serbinë. Marrëveshja për bashkëpunimin policor me Shqipërinë u nënshkrua me 6 tetor 2009, me Maqedoninë me 3 tetor 2011 dhe me Malin e Zi me 16 mars 2014.

4 Zyrtar i lartë në Ambasadën e Zvicrës në Prishtinë. Intervista me 25 prill 2014, Prishtinë.

ropë.⁵ Kështu, mosmarrëveshjet politike mes Kosovës dhe Serbisë kanë ndikim të jodrejt-përdrejtë në shtetet tjera të rajonit e poashtu edhe në shtetet e BE-së.

Për më tepër, mungesa e patrullimeve kufitare të shpeshta e të përbashkëta mes Kosovës dhe Serbisë hap derën për prerjen masive të lisave në pyje, sidomos në pjesën veriore të Kosovës. Nëse vazhdon trendi i tanishëm, kjo zonë shpejt do të mund të shpyllëzohet, duke shkaktuar dëme kolaterale edhe për Kosovën edhe për Serbinë.⁶ Gjithashtu, përkundër reputacionit për kontrabandimin e njerëzve, të dhënat nga Policia e Kosovës dhe Doganat e Kosovës për periudhën janar-mars 2014 nuk tregojnë asnjë dëshmi sa i përket këtij aktiviteti kriminal, duke përfshirë edhe pikëkalimet kufitare të saj me Serbinë dhe njësinë e ndërlidhur të doganave.

Në dritën e këtyre sfidave që burojnë nga mungesa e marrëdhënieve dypalëshe mes Kosovës dhe Serbisë, kjo analizë e politikave synon të hedhë dritë mbi atë se si realizohet bashkëpunimi policor mes dy shteteve. Së pari, ajo paraqet përgjithësisht dhe shtjellon arkitekturën institucionale në Kosovë që mundëson mënyrën aktuale të bashkëpunimit. Së dyti, ajo analizon mënyrën e bashkëpunimit policor formal dhe joformal, dhe të drejtpërdretë e jo të drejtpërdrejtë mes Kosovës dhe Serbisë. Së treti, ajo pasqyron sfidat aktuale të strukturës aktuale institucionale dhe mënyrës së bashkëpunimit në çështjet policore, pasuar me disa rekomandime. Para se të vazhdojmë, ia vlen të përmendet se kjo analizë e politikave shtjellon vetëm çështjet e bashkëpunimit policor “dypalësh”, dhe kështu nuk i adreson aspektet e tij shumëpalëshe. Ajo poashtu fokusohet vetëm në bashkëpunimin policor, dhe jo në çështjet tjera të ndërlidhura sa i përket gjyqësisë, siç është bashkëpunimi mes ministrive përkatëse të drejtësisë të të dy shteteve.

5 Zyrtar i lartë në Ambasadën e Zvicrës në Prishtinë. Intervista me 25 prill 2014, Prishtinë.

6 Zyrtar i lartë i EULEX-it që merret me aktivitetet MMA në veri. Intervista me 1 maj 2014, Prishtinë.

ARKITEKTURA INSTITUCIONALE

Bashkëpunimi policor ndërkombëtar i Kosovës, duke përfshirë bashkëpunimin e saj me autoritetet policore në Serbi, ndodh drejtpërdrejtë dhe jodrejt-përdrejtë përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit formal dhe joformal. Ky komunikim lehtësohet përmes angazhimit të një numri institucionesh dhe mekanizmash. Ia vlen të përmendet, megjithatë, se për shkak të shtetësisë së kontestuar të Kosovës dhe mungesës së saj të legjitimitetit të plotë ndërkombëtar, një numër institucionesh ndërkombëtare, bashkë me institucione të ndryshme vendore, përbëjnë arkitekturën e tërësishme institucionale përmes së cilës ndodhë bashkëpunimi policor mes Kosovës dhe shteteve tjera dhe organizatave ndërkombëtare, përfshirë Serbinë.

INTERPOL-i është njëra prej organizatave më të rëndësishme policore ndërkombëtare që përdoret nga shtetet për të lehtësuar bashkëpunimin e tyre në luftimin e aktiviteve të ndryshme kriminale. Të gjitha shtetet anëtare të INTERPOL-it kanë një Zyrë Qendrore Kombëtare [ZQK] që i lidh autoritetet policore kombëtare me rrjetin global të INTERPOL-it.⁷ Ajo shërben si pikë kontaktuese për aktivitetet e INTERPOL-it në secilin shtet anëtar, dhe kontribuon në bazat e të dhënave për aktivitete kriminale dhe bashkëpunon me ZQK-të tjera për hetimet, operacionet, dhe arrestimet ndërkufitare.⁸ Me fjalë tjera, dhe ashtu si edhe INTERPOL-i i percepton ato: “ZQK-të janë gjaku i jetës së INTERPOL-it”.⁹ Ndryshe prej shteteve tjera të njohura ndërkombëtarisht të cilat janë pjesë e INTERPOL-it, Kosova nuk ka mundësi ta ketë një ZQK. Si rezultat, ZQK e INTERPOL-it për Kos-

7 INTERPOL, “National Central Bureaus”. Qasur me: 02 maj 2014. Në dispozicion tek: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/Structure-and-governance/National-Central-Bureaus>

8 INTERPOL, “National Central Bureaus”. Qasur me: 02 maj 2014. Në dispozicion tek: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/Structure-and-governance/National-Central-Bureaus>

9 INTERPOL, “National Central Bureaus”. Qasur me: 02 maj 2014. Në dispozicion tek: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/Structure-and-governance/National-Central-Bureaus>

ovën është e vendosur në UNMIK, që paraqet një pengesë institucionale në mundësinë e Kosovës për të komunikuar drejtpërdrejtë me ZQK-të e shteteve tjera, përfshirë Serbinë.¹⁰

EUROPOL-i është një “agjenci tjetër për zbatimin e ligjit” e rëndësishme e BE-së që iu ndihmon shteteve anëtare të tij në luftën e tyre kundër krimeve të rënda ndërkombëtare dhe terrorizmit.¹¹ Në njohjen e natyrës ndërkombëtare të krimit të organizuar, EUROPOL-i tashmë ka vendosur disa nisma me shtetet tjera që s’janë në BE dhe organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor. Pasi jo të gjitha shtetet anëtare të BE-së kanë njohur Kosovën, nuk ka bashkëpunim të drejtpërdrejtë dhe marrëveshje strategjike mes EUROPOL-it dhe Kosovës. Si rezultat, është Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë [EULEX] që mban komunikim dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë me EUROPOL-in, gjë që, ashtu si në rastin e UNMIK-ut dhe INTERPOL-it, paraqet një pengesë institucionale në komunikimin e drejtpërdrejtë të Kosovës me palët tjera në EUROPOL.

Së treti, dhe si shtesë ndaj rolit të tij në mbajtjen e lidhjeve të drejtpërdrejta me EUROPOL-in, EULEX-i i adreson edhe zbraztësitë tjera ekzistuese në çështjet e bashkëpunimit policor mes Kosovës dhe Serbisë. Për shembull, EULEX-i ka nënshkruar një protokoll për bashkëpunim policor me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë [MUP] me 11 shtator 2009.¹² Si shtesë, EULEX-i ka një Zyre Ndërlidhëse në Beograd që ka 3-4 zyrtarë policorë me qëllim të mbajtjes së kontakteve të drejtpërdrejta dhe të afërta me Beogradin dhe me Delegacionin e BE-së në Beograd.¹³ Kështu, EULEX-i është një mekanizëm institucional që në mënyrë të pavarur dhe në emër të

vetin bashkëpunon me Serbinë për çështjet policore, mes tjerash.

Së katërti, me 3 mars 2011, Qeveria e Kosovës ka vendosur të themelojë Njësinë Bashkërenduese për Zbatimin e Ligjit Ndërkombëtar [NjBZLK] brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës.¹⁴ NjBZLK-të janë një projekt i nisur nga BE me qëllimin e përgjithshëm për krijimin e një “mekanizmi për bashkëpunim për zbatimin efektiv të ligjit ndërkombëtar në mesin e shteteve përfituese të Ballkanit Perëndimor dhe për të arritur bashkëpunimin e përmirësuar në zbatimin e ligjit ndërkombëtar në rajon”.¹⁵ NjBZLK-të janë dizajnuar që të përkrahin “këmbimin e informatave në hetimet ndërkombëtare dhe lehtësimin e kontakteve në nivelin operacional”.¹⁶ NjBZLK¹⁷ përfaqëson pikën qendrore kontaktuese të Kosovës për bashkëpunim policor ndërkombëtar. Kjo do të thotë se “të gjitha” informatat sa i përket bashkëpunimit policor kalojnë përmes NjBZLK-së, përfshirë edhe ato nga ZQK e UNMIK-ut, EULEX-i – edhepse joformalisht, atashetë policore të shteteve tjera partnere të pranishme në Kosovë dhe çfarëdo entiteti tjetër.¹⁸

Së pesti, një agjenci tjetër brenda Policisë së Kosovës e angazhuar drejtpërdrejtë në komunikim, dhe në një masë të caktuar në bashkëpunim, me Departamentin e Policisë Kufitare të Serbisë është Departamenti i

10 Zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë.

11 EURORPOL, “About Us”. Qasur me: 02 maj 2014. Në dispozicion tek: <https://www.europol.europa.eu/content/page/about-us>

12 B92, “MUP-EULEX protocol signed”. Qasur me 4 maj 2014. Në dispozicion tek: http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2009&mm=09&dd=11&nav_id=61706

13 Zyrtar i lartë në EULEX që merret me krimin e organizuar. Intervista me 6 maj 2014, Prishtinë

14 Republic of Kosovo [2011], “Memorandum of Understanding For coordination and support provided for International Law Enforcement Coordination Unit [ILECU]”. Në dispozicion tek: <http://www.psh-ks.net/repository/docs/ILECU.pdf>

15 RCC, [2008], “ Establishment of international law enforcement coordination units in Western Balkans launched in Vienna today”. Në dispozicion tek: <http://www.rcc.int/press/59/establishment-of-international-law-enforcement-coordination-units-in-western-balkans-launched-in-vienna-today>

16 RCC, [2008], “ Establishment of international law enforcement coordination units in Western Balkans launched in Vienna today”. Në dispozicion tek: <http://www.rcc.int/press/59/establishment-of-international-law-enforcement-coordination-units-in-western-balkans-launched-in-vienna-today>

17 Me qëllim të bashkërendimit të veprimeve dhe rritjes së efektshmërisë së Njësisë në Kosovë, u nënshkrua një Memorandum i Mirëkuptimit [MiM] mes ministrive të Punëve të Brendshme, Drejtësisë, dhe Financave dhe Prokurorit të Shtetit me 20 prill 2014.

18 Zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

Policisë Kufitare të Kosovës. Ky mekanizëm institucional për bashkëpunim policor mes Kosovës dhe Serbisë u bë funksional së voni pasi u arrit pajtimi për protokollin teknik për zbatimin e MIK-ut me 24 shkurt 2013 gjatë rrethit të nëntë të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.¹⁹ Prandaj është e qartë se arkitektura institucionale për bashkëpunim policor me shtetet tjera, përfshirë Serbinë, është me komplekse sesa që mund të gjendet në shtetet tjera të njohura ndërkombëtarisht. Prania e UNMIK-ut dhe EULEX-it ndihmon në mbajtjen e Kosovës në radarin e autoriteteve policore të shteteve tjera, por në të njëjtën kohë ajo gjithashtu paraqet pengesë institucionale për autoritetet policore të Kosovës.

MËNYRA E BASHKËPUNIMIT

E tërë arkitektura institucionale e diskutuar më lartë angazhohet në mundësimin e bashkëpunimit policor mes Kosovës dhe Serbisë. Disa prej këtyre mekanizmave angazhohen drejtpërdrejtë dhe formalisht në komunikimin me autoritetet policore në Serbi, ndërsa të tjerët komunikojnë jodrejtpërdrejtë dhe joformalisht.

Bashkëpunimi në nivelin qendror

Kanali i parë i komunikimit mes autoriteteve policore të Kosovës dhe Serbisë është komunikimi dhe bashkëpunimi formal që ndodh jodrejtpërdrejtë përmes ZQK-së së UNMIK-ut. Ky kanal i komunikimit mes autoriteteve policore të Kosovës dhe Serbisë përdoret për të këmbyer informata për aktivitetet kriminale siç janë vjedhja e veturave, dokumentet e falsifikuara dhe të ngjashme.²⁰ Komunikimi përmes këtij kanali ndodh të paktën në baza ditore dhe shpesh disa herë në ditë.²¹

19 European Union, Presse 9, "Press statement: EU facilitated dialogue - Agreement on Regional Cooperation and IBM technical protocol", 24 shkurt, 2012, http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/EN/foraff/128138.pdf

20 Zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

21 Zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

UNMIK-u poashtu luan rol ndërmjetësues mes autoriteteve policore të Kosovës dhe Serbisë në çështjet administrative dhe ligjore siç janë verifikimi i çertifikatave, vlefshmëria e dokumenteve zyrtare, urdhër-arrestet dhe çështje tjera civile, në të cilat ZQK-të nuk janë të përfshira.²² Janë gjithsejt 11 anëtarë stafi ndërkombëtarë, 4 nga UNMIK-u dhe 7 nga EULEX-i, që janë të angazhuar në ZQK-në e UNMIK-ut me qëllim të lehtësimin të bashkëpunimit policor mes Kosovës dhe shteteve tjera, përfshirë Serbinë.²³ Një anëtar tjetër i stafit vendor është i përfshirë në këtë zyrë në UNMIK.

Kanali i dytë i komunikimit është komunikimi dhe bashkëpunimi i drejtpërdrejtë dhe joformal mes NjBZLK-ve në Kosovë dhe Serbi. Në shumicën e rasteve, komunikimi i tillë ndodh përmes linjës së drejtpërdrejtë telefonike, dhe ashtu si me NjBZLK-të tjera në rajon, NjBZLK-ja e Kosovës është vetëm një shtypje suste larg nga Serbia.²⁴ Ka pasur një numër rastesh në të cilat komunikimi i tillë i drejtpërdrejtë ka pasur përfitime edhe për Kosovën edhe për Serbinë në adresimin e krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera kriminale në të dyja anët e kufirit. Për shembull, kur dy qytetarë të Serbisë të dyshuar për përfshirje në një vrasje në Serbi gjetën strehim në Kosovë, komunikimi i drejtpërdrejtë mes dy NjBZLK-ve mundësoj kthimin e dy të dyshuarve nga Kosova në Serbi në një operacion të përbashkët, por të bashkërenduar joformalisht. NjBZLK e Serbisë e kontaktoj NjBZLK-në e Kosovës drejtpërdrejtë, dhe u këmbyen informatat për të dyshuarit. Policia e Kosovës hapi hetimet, i zuri të dyshuarit dhe i vendosi ata në paraburgim. Në fakt nuk kishte kurrfarë urdhërarresti për të dyshuarit, por ata u arrestuan mbi akuzën për posedim të narkotikëve. NjBZLK-ja e Kosovës e informoi NjBZLK-në në Serbi që të dyshuarit ishin paraburgosur, dhe u pajtuan për kohën dhe vendin për dorëzimin e tyre nga Kosova në

22 Zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

23 Zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

24 Zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

Serbi. Megjithatë, duke pasur parasysh joformalitetin e këtij komunikimi të drejtpërdrejtë, të dyshuarit nuk ishte e mundur dhe nuk u dorëzuan zyrtarisht tek autoritetet serbe, por vetëm “u liruan” në pikëkalimin kufitur të pajtuar. Autoritetet e Kosovës megjithatë e regjistruan këtë si “deportim” e jo “dorëzim”, pasi që nuk ka asnjë marrëveshje për ekstradim zyrtar mes dy shteteve. Pas “lirimit” autoritetet e Policisë së Serbisë, të cilët prisnin në anën tjetër të kufirit, i riarrestuan të dyshuarit.²⁵

Ngjashëm, Serbia i është përgjigjur pozitivisht kërkesave nga Kosova rreth të dyshuarëve të ndryshëm në arrati në Serbi. Në raste të tilla, Serbia pajtohet të angazhojë autoritetet e policisë së saj jozyrtarisht si përgjigje ndaj kërkesave të Kosovës, por Kosova duhet të dorëzojë kërkesën zyrtarisht përmes ZQK-së së INTERPOL-it të UNMIK-ut.²⁶ Zyrtarët e UNMIK-ut janë të prirë të ngrisin pyetje të shumta rreth kërkesave reciproke të Kosovës dhe Serbisë, por të dyja palët përgjithësisht përgjigjen menjëherë në mënyrë që ta bindin ZQK-në e UNMIK-ut që mos ta vonojë rastin. Të dyja NjBZLK-të kanë mirëkuptim shumë më të mirë për raste të tilla dhe urgjencën e tyre për shkak të komunikimit të tyre të mëparshëm kur nuk ishte e përfshirë ZQK-ja e UNMIK-ut.²⁷

Një kanal tjetër i drejtpërdrejtë i komunikimit për çështjet e bashkëpunimit policor mes Kosovës dhe Serbisë është ai mes EULEX-it dhe MUP-it të Serbisë. Një linjë e komunikimit kalon përmes Zyrës Ndërlidhëse të EULEX-it në Beograd, ndërsa tjetra është e drejtpërdrejtë, mes zyrtarëve të EULEX-it në Kosovë dhe MUP-it të Serbisë, siç duket në pajtim me Protokollin për Bashkëpunim Policor i nënshkruar në shtator 2009. Problemi me këtë kanal komunikimi është se ai e sfidon mundësinë e Kosovës që të kuptojë çështjet që diskutohen nga EULEX-i dhe MUP-i i Serbisë, pasi që

EULEX-i vepron si mision i pavarur në Kosovë. Kjo është veçanërisht problematike pasi, ndryshe prej deklaratës se ish Udhëheqësit të Misionit Yves de Kermabon se, “[t]ë gjitha informatat e marra [në kontaktet me Serbinë] do të ndahen me autoritetet relevante të Kosovës për të mirën e institucioneve për sundimin e ligjit,”²⁸ autoritetet e Policisë së Kosovës janë të vetëdijshme se EULEX-i nuk i ndan të gjitha informatat e tilla.²⁹

Duket se zyrtarët e Policisë së Kosovës zakonisht kanë një rol në mbledhjen e informatave për hetimet e përbashkëta dhe operacionet policore. Megjithatë, zyrtarët e Policisë së Kosovës nuk janë të vetëdijshëm për atë se çfarë bën EULEX-i apo me kënd ai i ndan informatat që i mbledhë, sidomos nëse është i përfshirë në operacionet e përbashkëta ndërkufitare me MUP-in e Serbisë.³⁰ Siç tha një zyrtar i Policisë së Kosovës: “ata e dinë se çka dini ju; ju nuk e dini çfarë dinë ata”.³¹ Takimet e rregullta mujore mes përfaqësuesëve të EULEX-it dhe përfaqësuesëve të MUP-it në Beograd i diskutojnë çështjet e ndërlidhura me parandalimin e krimit të organizuar dhe aktivitetet tjera kriminale.³²

Bashkëpunimi me autoritetet kufitare

Një kanal tjetër i komunikimit dhe bashkëpunimit mes autoriteteve policore të Kosovës dhe Serbisë është ai mes departamenteve të tyre përkatëse të Policisë Kufitare. Takimet e rregullta javore ndodhin në nivel lokal mes autoriteteve të policisë kufitare nga secila prej gjashtë pikëkalimeve kufitare. Si shtesë takimet e rregullta mujore ndodhin në nivel rajonal mes departamenteve të policisë rajonale të Kosovës dhe Serbisë. Të gjitha

25 Zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

26 Zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës, Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

27 Zyrtar i lartë në Policinë e Kosovës, Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

28 <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0016.php>

29 Zyrtar i lartë në rajonin policor në veriun e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

30 Zyrtar i lartë në rajonin policor në veriun e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

31 Zyrtar i lartë në rajonin policor në veriun e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

32 Alan Edwards, EULEX. Intervista me 6 maj 2014, Prishtinë

këto takime, të lehtësuara nga EULEX-i, janë bashkëpunuese për nga natyra, dhe autoritetet nga të dyja palët zakonisht këmbëjnë larmi informatash dhe diskutojnë çështjet infrastrukturore dhe zgjidhjet për problemet e ndryshme me të cilat ata përballen.³³ Para nënshkrimit të marrëveshjes për MIK në dhjetor 2012 dhe protokollin e ndërlidhur për zbatim, të pajtuar në shkurt 2013, asnjë takim nuk ka ndodhur mes autoriteteve kufitare të të dy palëve. Informatat janë këmbyer dhe kontaktet janë bërë ekskluzivisht përmes EULEX-it.³⁴ Në atë kohë, kur qytetarët e ndonjëres palë arrestoheshin për prerje ilegale të pyjeve, për shembull, kërkonte kohë të gjatë për të këmbyer informatat mes dy autoriteteve.³⁵ Çështjet e tilla tani diskutohen ose në pikëkalimet kufitare derisa problemet ndodhin ose ne takimet e rregullta javore dhe mujore.

Kosova ushtron patrullime të përbashkëta e të rregullta kufitare me të gjitha shtetet fqinje përveç me Serbinë,³⁶ pasi Serbia është i vetmi shtet fqinj me të cilin Kosova nuk ka asnjë marrëveshje për demarkacionin e kufirit. Si e tillë, KFOR-i nuk i ka transferuar përgjegjësitë për patrullimin e kufirit me Serbinë tek Policia Kufitare e Kosovës, ashtu siç ka bërë për të gjitha shtetet tjera fqinje.

SFIDAT

Disa sfida paraqiten nga struktura aktuale institucionale dhe mënyra përcjellëse e bashkëpunimit mes autoriteteve policore të Kosovës dhe Serbisë:

- Roli i EULEX-it dhe UNMIK-it në ndërmjetësimin dhe lehtësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit mes autoriteteve policore në Kosovë dhe Serbi nënkupton që Kosova nuk i zotëron informatat që këmbehen. EULEX-i dhe UNMIK-u vendosin cilat informata do të ndahen me Policinë e Kosovës, që do të thotë se derisa kjo e fundit e di se cilat informata ndahen, ajo kurrë nuk mund të jetë e sigurtë se cilat informata nuk janë duke u ndarë. Në këtë kontekst, këmbimi i informatave mes këtyre institucioneve ndërkombëtare është në pronësinë dhe diskrecionin e përfaqësuesëve të EULEX-it dhe UNMIK-it dhe disa dhjetra shtetesh që ata përfaqësojnë.
- Ka raste në të cilat EULEX-i i ekzekuton operacionet në Kosovë bashkë me Serbinë sipas një plani operacional të ndërlidhur. Në raste të tilla Kosova shpesh nuk ka kurrfarë autoriteti që të jetë e përfshirë, që do të thotë se Policisë së Kosovës i mungon kontrolli i plotë i informatave dhe bashkëpunimi policor ndërkombëtar që është i nevojshëm për një shtet që t'i kryejë hetimet me efektivitet.³⁷

33 Zyrtar i lartë në Divizionin për MIK në Policinë e Kosovës. Intervista me 29 prill 2014, Prishtinë

34 Zyrtar i lartë në Divizionin për MIK në Policinë e Kosovës. Intervista me 29 prill 2014, Prishtinë

35 Zyrtar i lartë në Divizionin për MIK në Policinë e Kosovës. Intervista me 29 prill 2014, Prishtinë

36 Zyrtar i lartë në Divizionin për MIK në Policinë e Kosovës. Intervista me 29 prill 2014, Prishtinë

37 Zyrtarë i lartë në Policinë e Kosovës. Intervista me 17 prill 2014, Prishtinë

REKOMANDIMET

- Kosova dhe Serbia duhet të arrijnë dhe nënshkruajnë një marrëveshje për bashkëpunim policor me synimin e përgjithshëm të parandalimit, zbulimit dhe luftimit të krimit në një numër fushash. Marrëveshjet për bashkëpunim policor mes Kosovës dhe fqinjëve të saj dhe atyre mes Serbisë dhe fqinjëve të saj duhet përdorur si shembuj, duke marrë parasysh karakteristikat e të dyja palëve;
- Kosova dhe Serbia duhet të "formalizojnë" komunikimin dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë i cili ndodh përmes NjB-ZLK-ve të tyre. Kështu, përveç këmbimit të informatave, ato mund ta kapitalizojnë këtë komunikim dhe të organizojnë operacione të përbashkëta të drejtpërdrejtë, pa kaluar domosdoshmërisht përmes ZQK-së së UNMIK-ut;
- Kosova dhe Serbia duhet të kalojnë përtej komunikimit të drejtpërdrejtë në nivel qendror përmes NjBZLK-ve të tyre përkatëse. Ato duhet të këmbëjnë atashetë policor përmes Zyrave Ndërlidhëse në kryeqytetet e tyre përkatëse;
- Kosova duhet të nënshkruajë më shumë marrëveshje dypalëshe për bashkëpunim policor me shtetet që e kanë njohur Kosovën në mënyrë që t'i kundërpërgjigjet problemit të pronësisë dhe efikasitetit të këmbimit të informatave. Si shtesë ndaj ZQK-së së UNMIK-ut, duhet të vendosen kontakte të drejtpërdrejta me shtetet tjera që janë të rëndësishme për luftën kundër aktiviteteve kriminale që e kërcënojnë edhe Kosovën edhe palën tjetër të marrëveshjes;
- Duke marrë parasysh finalizimin e procesit të integrimit të strukturave të MUP-it në Policinë e Kosovës në pajtim me Marrëveshjen e Brukselit, Serbia duhet të fillojë ndarjen e informatave me NjBZLK-në e Kosovës për aktivitetet kriminale në Kosovën veriore. Informatat duhet të dorëzohen tek komandanti i rajonit policor verior, i cili duhet t'i përdorë ato për të mirën e popullatës lokale dhe sigurisë së tyre;
- Duhet bërë më shumë përpjekje dhe duhet patur diskutime me përfaqësuesit e BE-së me synim të nënshkrimit të një marrëveshje strategjike me EUROPOL-in, ashtu siç kanë bërë shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor.

RRETH AUTORIT

Shpend KURSANI është Hulumtues i Lartë i Jashtëm në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë - QKSS. Aktualisht Shpendi është gjithashtu anëtar i Kuvendit në Këshillin e Prishtinës për Marrëdhënie me Jashtë - KPMJ, dhe Themelues dhe Anëtar i Komitetit Drejtues në Balkan Think Tense - BTT. Ai është gjithashtu ligjërues në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Kolegjin Universitar Universum. Gjatë viteve 2011-2013 ai ishte hulumtues i lartë në Institutin Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave - KIPRED, ku ai botoi një numër të analizave politike që në përgjithësi kanë të bëjnë me funksionimin dhe zhvillimin politik të marrëdhënieve të Kosovës dhe të marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë dhe aktorët tjerë ndërkombëtarë. Shpendi ka ndjekur studimet master në Universitetin Cambridge (2010-2011) ku edhe fitoi diplomën e tij M.Phil në Marrëdhënie Ndërkombëtare në veçanti me temën e tij të diplomës "Përdorimi i Soft Power: Aftësia e BE-së që të ndikojë në politikat e brendshme dhe të huaja të shteteve të Ballkanit Perëndimor". Ai ka përfunduar studimet bachelor në Politika Publike dhe Menaxhment me nderimet më të larta nga Universiteti Amerikan në Kosovë (2003-2007).

PËR ORGANIZATAT

QENDRA E BEOGRADIT PËR POLITIKA TË SIGURISË (BCSP) Serbi

Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë (QBPS) është një think-tank i pavarur që nga viti 1997 duke avokuar publikisht për sigurinë kombëtare dhe njerëzore të bazuar në demokraci dhe të drejtat e njeriut. BCSP punon në drejtim të konsolidimit të sektorit të sigurisë (RSS) dhe integritit të sigurisë të shteteve të Ballkanit Perëndimor në bashkësinë Euro-atlantike, duke krijuar një mjedis të politikave të sigurisë bazuar në njohuri gjithëpërfshirëse. Te gjitha këto objektiva i arrin nëpërmjet hulumtimit, avokimit publik, arsimimit, si dhe duke sjellë së bashku palët e interesuara për krijimin e kontakteve dhe bashkëpunimeve të ndryshme.

QENDRA KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (QKSS) Kosovë

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është një organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2008 me qëllim kryesor të zhvillojë studimet kërkimore-shkencore, në sektorin e sigurisë. QKSS zhvillon hulumtime dhe organizon konferenca dhe seminare në fushën e politikave të sigurisë, sundimit të ligjit, drejtësisë, dhe monitorimin e sektorit të sigurisë. Aktivitetet e QKSS-së kontribuojnë në forcimin e parimeve të mbikëqyrjes demokratike të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës.

RRETH PROJEKTIT

Forumi Hulumtues i Sigurisë është një projekt i përbashkët në mes të tri qendrave të pavarura hulumtuese nga Beogradi (BCSP), Prishtina (QKSS) dhe Tirana (IDM) të specializuara në hulumtimin e çështjeve të sigurisë. Projekti ka për qëllim të nxisë debat të balancuar midis qendrave hulumtuese (think-tank), komunitetit akademik, politikës publike dhe medias, në mënyrë që të sigurojë zgjidhje alternative për sfidat e vazhdueshme të bashkëpunimit ndërmjet Serbisë, Kosovës dhe Shqipërisë.

